

# Mirëqeverisja dhe shteti i së drejtës

Gjetjet kryesore mbi çështjet që lidhen me llogaridhënien e administratës, e drejta e pronës

Erinda Meli

# 1. Të Drejtat e Pronës (Regjistrimi i pronës, Shërbimet kadastrale, Legalizimi dhe Kompensimi, si dhe ndërtimet e kundërligjshme)


- ▶ **Stoku i çështjeve:** Gjatë vitit 2025, AP përfundoi shqyrtimin e 118 rasteve me objekt ankimi veprimtarinë e ASHK.
- ❖ Regjistrimi i titujve të pronësisë - Një numër i lartë vendimesh gjyqësore dhe të Agjencisë së Trajtimit të Pronës për njohjen dhe kompensimin e pronës (27,023) ende të paregjistruara.
- ▶ **Vonesat Sistematike:** Cenimi i të drejtës së pronës shpesh buron nga pasiguria juridike si rrjedhojë e vonesave të gjata administrative, paqartësive procedurale dhe mungesës së transparencës nga institucionet publike.
- ❖ Vonesa në procesin e regjistrimit fillestar të titujve të pronësisë/në dhënien e shërbimeve të ndryshme kadastrale.

- ❖ **Shembull:** Disa banorë të fshatit Dhërmi, Bashkia Himarë, në kuadër të njoftimit publik të bërë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, mbi fillimin e procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme në zonën ku ndodheshin pronat e tyre, dhe bazuar në ligj kishin depozituar dokumentacion që dispononin, pranë Bashkisë Himarë. Nga ana jonë u konstatua se ishin shkelur afatet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në trajtimin e shqyrtimit të kërkesës së dy familjeve, veçanërisht nga DVASHK Vlorë. Kjo pasi Bashkia Himarë, bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit 20/2020, i kishte përcjellë dosjet e ankuesve në ASHK dhe DVASHK Vlorë, që në muajin shkurt 2021, por nga ana e kësaj të fundit, nuk ishin kryer veprime e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

# Raste me objekt ankimi ndaj Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

181 raste të trajtuara në 2025

- Raste të mbartura në 2025
- Rastë të reja të regjistruara në 2025
- Raste të mbyllura gjatë 2025



## ▶ Joefikasiteti në procesin kalimtar të pronësisë për Legalizimin e ndërtimeve pa leje

- ❖ Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje, vuan nga një ritëm tejet i ngadaltë.
- ❖ Nga ankesat e shqyrtuara ka rezultuar se në shumë raste procedura administrative, edhe kur është iniciuar prej vitesh, nuk ka kaluar as në fazat minimale të shqyrtimit. Këtu duhet të mbahet parasysh fakti se kemi ende vetëdeklarime/aplikime për legalizimin e ndërtimeve pa leje të paraqitura që prej vitit 2005-2006, të cilat ende nuk janë shqyrtuar.
- ❖ Ka një mungesë të theksuar komunikimi me palët e interesuara dhe mosrespektim thelbësor të së drejtës për informim.
- ❖ Në shumë praktika, qytetarët nuk janë njoftuar mbi fazat e trajtimit të kërkesës së tyre, nuk janë vënë në dijeni për pengesat procedurale apo teknike dhe nuk kanë marrë shpjegime të plota mbi mosveprimin e administratës.

- ❖ Shqetësim me natyrë strukturore lidhet me paqartësinë reale mbi mundësinë e përfundimit të procesit brenda afatit të përcaktuar në nenin 82 të ligjit nr. 20/2020, sipas të cilit legalizimi duhet të përfundojë më 31 dhjetor 2028.
- ❖ Edhe procese të tjera administrative legalizimi, sikundër ai i kalimit të pronësisë së objektit të ndërtuar para gushtit të vitit 1991 dhe truallit të tij funksional, që ndonëse në një numër më të ulët ankesash, paraqesin problematikë në ecurinë e trajtimit të tyre.
- ❖ Të dhënat e publikuara nga ASHK-ja për vitin 2024 tregojnë se për periudhën 2006-2024 janë nxjerrë gjithsej 265.013 vendime për legalizim ose përjashtim nga procesi i legalizimit, prej të cilave 4.270 janë vendime për përjashtim;
- ❖ Por mungon një e dhënë statistikore e plotë për numrin e vetëdeklarimeve apo aplikimeve që mbeten ende në proces shqyrtimi.


❖ Autoritetet nuk respektojnë afatin ligjor prej 60 ditësh për të marrë një vendim për legalizimin ose jo të ndërtimit të paligjshëm, pas verifikimeve në terren.

- **Shembull:** Në vijim të një rasti me iniciativë, dhe ngritjes së një grupi pune dhe zhvillimit të inspektimeve në DVASHK Tirana Veri dhe DVASHK Durrës-Kavajë-Krujë lidhur me zbatimin e afatit 60 ditor pas evidentimit, në terren, iu rekomandua Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së:
  - ✓ hartimi i udhëzimeve të posaçme për regjistrimin dhe protokollimin e evidentimeve në terren
  - ✓ Garantimi i gjurmueshmërisë efektive të procedurave
  - ✓ raportim periodik të drejtorive vendore dhe identifikimi i rasteve ku janë kryer verifikime të përsëritura në terren ose ku ka kaluar afati 60-ditor pa një vendim përfundimtar.

- ❖ **Shembull:** Rast sistemik lidhur me mosshfaqjen në sistemin elektronik të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme të ASHK-së të aplikimeve për legalizim të paraqitura nga qytetarët.
- ✓ Nga hetimi administrativ rezultoi drejtoritë vendore nuk kishin akses për të hedhur këto aplikime në sistem dhe, në të njëjtën kohë, nuk ndërmerrnin veprime të mjaftueshme për ta adresuar këtë problem pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.
- ✓ Hetimi i ankesave lidhur me mosshfaqjen e aplikimit në sistem evidentoi se as qytetarët nuk njoftoheshin në të tilla raste.
- ✓ Për të shmangur përsëritjen e këtyre rasteve, AP rekomandoi:
- ✓ Të gjitha DVASHK-të të udhëzohen të njoftojnë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme sa herë që marrin dijeni për një aplikim të tillë, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të sigurojë hedhjen e aplikimit në sistemin elektronik pa vonesa të mëtejshme.

# Raste të trajtuara me objekt legalizimet

132 raste të trajtuara në 2025




# Rekomandime me objekt legalizimet

## 14 rekomandime të dërguara në 2025

■ 2 Rekomandime sistemike në 2025

■ 12 Rekomandime individuale në 2025




## ▶ Ritme të Ulëta Kompensimi

- ❖ Shifrat tregojnë ritme shumë të ulëta ekzekutimi të vendimeve për kompensim.
- ❖ Nga 2,570 kërkesa për kompensim të administruara, deri në fund të vitit 2024 ishin ekzekutuar efektivisht vetëm 870.
- ❖ Nga 27,023 vendime përfundimtare, 6,491 mbeten pa asnjë vlerësim financiar.
- ❖ Edhe pse kuadri ligjor është ndryshuar duke shtyrë afatet deri në vitet 2027-2028, kompensimi vazhdon me ritëm të ngadaltë, vlerësimi financiar i stokut historik mbetet i papërfunduar, dhe trajtimi i kërkesave për kthim/kompensim nuk është përmbyllur ende.

# Raste me objekt kompesimin e pronës

22 raste të trajtuara në 2025



- Raste të trajtuara gjithsej në 2025
- Raste të mbyllura në 2025


## ▶ Shkeljet në proceset e shpronësimit për interes publik

- ❖ Për disa prona private, veprat publike janë ndërtuar përpara se Këshilli i Ministrave të miratojë vendimin formal për shpronësimin dhe dëmshpërblimin e pronarëve, gjë që ka sjellë përkeqësimin e situatës juridike të këtyre pronarëve.
- ❖ Shpesh dëmshpërblimi ekzekutohet me shumë vonesë në kundërshtim me ligjin nr. 8561/1999

# Rastet me objekt shpronësimit për interes publik

16 raste të trajtuara në 2025

- Raste të reja të regjistruara në 2025
- Raste të mbartura në 2025




## 2 Kontrolli i Territorit dhe Ndërtimet e Kundërligjshme

### ▶ Ndërhyrje Arbitrare

- ❖ Ndërhyrjet për prishjen e objekteve nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe inspektoratet vendore (IMT) shpesh kanë shfaqur shkelje të procedurave ligjore dhe mungesë garancish, sikundër është vërejtur mosveprimi i IKMT-së dhe i IMT-ve për fillimin e procedurave të konstatimit dhe sanksionimit të ndërtimeve të kundërligjshme.
- ❖ Shmangie e detyrimit për ushtrimin e kompetencave ligjore, në formën e tejkalimit ose keqinterpretimit të kompetencave ligjore, në raste të caktuara.
- ❖ Mungesë transparence, raportimi i vonuar ose i paplotë midis IMT-ve dhe IKMT-së, mosdhënia e informacionit të kërkuar nga institucioni i Avokatit të Popullit
- ❖ Neglizhencë e IKMT-së në rastet kur legjislacioni parashikon që ky organ të ushtrojë kompetencat e IMT-ve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.
- ❖ Mosbashkëpunim midis IMT-ve dhe bashkive për mbështetje teknike


- ❖ Ndërhyrjet e organeve inspektuese nuk duhet të mbështeten në logjikën e aksioneve ad hoc, por në një qasje të përditshme, aktive dhe proaktive.
- ❖ Aksionet për lirimin e hapësirave publike në qendrat urbane dhe zonat turistike, pavarësisht se janë vlerësuar si zhvillime pozitive në mbrojtjen e pronës publike, nuk duhet të zëvendësojnë ushtrimin e rregullt dhe të vazhdueshëm të funksioneve të IMT-ve dhe IKMT-së.
- ▶ **Shembull:** Në Durrës, IMT-ja prishi disa banesa pa pasur aktin thelbësor administrativ: vendimin për prishjen e objektit. Kjo ndërhyrje u krye gjithashtu përpara se familjeve t'u garantoheshin masat efektive të strehimit.

# Raste me objekt ndërtimet e paligjshme



# Rekomandime për ndërtimet e paligjshme (Rezistencë e lartë nga autoritetet për të korrigjuar shkeljet)

■ 15 Rekomandime të dërguara për 104 rastet e trajtuara në 2025 (9 refuzuar nga autoritetet dhe 3 pa përgjigje)




## 3. Emergjencat Civile

### ▶ Vonesa Ekstreme në Kompensim

- ❖ Problem nuk është mungesa e kuadrit ligjor, por mosmaterializimi dhe zvarritja e skajshme e shpërndarjes së ndihmës financiare për qytetarët e prekur.
- ❖ Kjo ka sjellë për pasojë mosrealizimin real të së drejtës për kompensim, të mbetur për periudha shumë të gjata në nivel formal të njohjes së saj, pa prodhuar rimëkëmbje reale për qytetarët e prekur.
- ❖ Mungesa e fondeve, planifikimi i pamjaftueshëm buxhetor, paqartësitë në shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet bashkive dhe AKMC-së, si edhe mungesa e një afati të besueshëm për përfundimin e praktikave, vazhdojnë të prodhojnë pasiguri juridike dhe të cenojnë besimin e qytetarëve të administrata.
  - ▶ **Shembull:** Qytetari Q.K. ka pritur për më shumë se 15 vjet për shlyerjen e pjesës së mbetur të kompensimit pas dëmtimit nga përmbytja e marsit 2010, pavarësisht dokumentacionit të plotë. AP kishte ndërhyrë më herët me rekomandime që në 2015 dhe 2016.

# Rekomandime për emergjencat civile

■ 3 rekomandime të dërguara për 10 rastet e trajtuara në 2025




## 4. Shërbimet Publike dhe Infrastruktura

- ▶ **Mungesa e Infrastrukturës në periferi:** U trajtuan rreth 180 ankesa për probleme me rrugët, ndriçimin publik, kanalizimet, sinjalistikën, sigurinë në hapësirat publike dhe menaxhimin e mbetjeve. Vihet re një diferencë në cilësinë e shërbimeve midis zonave urbane të zhvilluara dhe zonave rurale, apo atyre periferike, ku shërbimet paraqiten më të pamjaftueshme dhe më të paqëndrueshme për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe mungesës së planifikimit afatgjatë.

- ▶ **Shembull:** 57 familje në lagjen "Postobllok" të bashkisë Kuçovë vuajnë nga mungesa e një sistemi kanalizimesh për ujërat e ndotura
- ▶ **Shembull:** me iniciativë (ex-officio) është trajtuar mungesa e sinjalistikës rrugore dhe të barrierave mbrojtëse në segmentin Harku i Bërdicës-Kthesa e Darragjatit, duke kërkuar masa emergjente nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, rritje të bashkëpunimit me Bashkinë Shkodër dhe ndërhyrje të menjëhershme për garantimin e sigurisë rrugore

# Rekomandime për infrastrukturën

■ 3 rekomandime të dërguara për 180 rastet e trajtuara në 2025



## ▶ Shërbimet bazike

- ❖ Avokati i Popullit trajtoi 76 raste për shërbimet bazike: 46 për ujin e pijshëm dhe 30 për energjinë elektrike.
- ❖ Shqetësimet kryesore përfshijnë mbifaturimet, faturimet aforfe dhe ndërprerjet e pajustificuara.
- ❖ FSHU sh.a. dhe Shoqëritë Ujës-jellës-Kanalizime sh.a, në një numër të konsiderueshëm rastesh nuk kanë respektuar standardet procedurale të kërkuara dhe nuk kanë zbatuar siç duhet dispozitat që lidhen me mbrojtjen e kategorive vulnerabël.

▶ Rekomandimet për furnizimin me energji elektrike

AP ka rekomanduar FSHU-në

- ✓ fshirjen e detyrimeve të pabazuara
- ✓ Rregullimin e faturimeve të pasakta
- ✓ Evidentimin e përgjegjësive individuale dhe institucionale që kanë sjellë cenimin e të drejtave të konsumatorëve
- ✓ Forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe transparencës

▶ Rekomandimet për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizime


AP ka kërkuar

- ✓ marrjen e masave të posaçme për mbrojtjen e konsumatorëve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve bazike, duke rekomanduar projekte të mirëfillta për zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve, investime në rrjetin e ujit të pijshëm dhe në disiplinimin e ujërave të ndotura, si dhe jetësimin e projekteve të nevojshme nga bashkitë dhe shoqëritë rajonale të ujësjellës-kanalizimeve.

- ✓ Kur është konstatuar mungesë kanalizimesh, AP ka kërkuar të dhëna konkrete nëse janë hartuar dhe zbatuar projekte rehabilitimi, nëse është ofruar mbështetje teknike nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe nëse janë siguruar fonde nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nga bashkitë ose nga subjektet përgjegjëse.
- ✓ AP ka rekomanduar forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, hartimin e projekteve të integruara rajonale, investime të koordinuara, monitorim teknik të vazhdueshëm dhe përfshirje të komunitetit në proceset planifikuese.
  - ▶ **Shembull:** Rekomandim për zbatimin e projektit të mbulimit me rrjet kanalizimesh të disiplinimit të ujërave të ndotura në zonat e zgjerimit të Bashkisë Lezhë sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Planit të Detyruar Vendor të Bashkisë Lezhë.
  - ▶ **Shembull:** Lidhur me shqetësimet e paraqitura nga banorët e lagjes "Perash" në Shkodër, Avokati i Popullit ka rekomanduar analizimin efektiv të funksioneve të UK Shkodër sh.a. në raport me rrjetin e kanalizimeve dhe mbrojtjen nga përmbytjet, përpos marrjes së masave administrative për mungesën e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit.

# Raste të trajtuara me objekt ankimi për shërbimet bazike

76 raste të trajtuara për shërbimet bazike




- Raste të trajtuara lidhur me ujin e pijshëm në 2025
- Raste të trajtuara lidhur me energjinë elektrike në 2025

# Rekomandime të dërguara për shërbimet bazike

6 rekomandime për 76 rastet e trajtuara në 2025

■ Rastet për shërbimin me energji elektrike

■ Rastet për shërbimin me ujë të pijshëm



# TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

1. Liria e tubimit dhe procedurat policore
2. Vonesat në Sistemin e Drejtësisë
3. Kushtet në Vendet e Privimit të Lirisë (Burgjet)
4. Azili dhe Migracioni

# Çështja 1: LIRIA E TUBIMIT DHE PROCEDURAT POLICORE

## Gjetjet Paraprake: Hapësira qytetare dhe garancitë procedurale:

- 1. Hapësira qytetare e kufizuar:** Hapësira qytetare në Shqipëri mbetet "*e limituar*" për shkak të kufizimeve të së drejtës për tubim.
  - ❖ Autoritet e institucioneve ligjzbatuese shpesh ndërhyjnë për të ndryshuar vendin/rrugën e kërkuar
  - ❖ Gjoha/sanksione me efekt dekurajues/ "chilling effect" – dekurajimi i protestuesve
  - ❖ Mosnjohje e tubimeve spontane
  - ❖ Presion dhe stigmatizim - retorikë negative nga autoritetet/presion administrativ apo institucional ndaj qytetarëve që dalin në protestë;
  - ❖ Mungesë mekanizmash ankimi efektiv

# Procedurat Policore

## 2. Garancitë procedurale në polici:

- ❖ Shoqërime pa kriter të protestuesve dhe në tejkalim të afateve të shoqërimit;
- ❖ Mungesa në dokumentacion lidhur me orën e shoqërimit dhe të ndalimit;
- ❖ Kushtet e mbipopullimit në dhomat e shoqërimit pas proteste;
- ❖ Mungesa e ekzaminimit shëndetësor fillestar;
- ❖ Mungesë e dhomave të intervistimit/rregjistrimi audio-viziv;
- ❖ Mbrojtja efektive e të shoqëruarve

**2.1 Të miturit në protesta (Rasti Hotolisht):** Evidentohen raste të marrjes në pyetje pa praninë e prindit dhe/apo psikologut, mosregjistrimi në regjistrat përkatës dhe mungesa e procedurave standarde policore për trajtimin e fëmijëve në situata tensioni. Edhe në rastet kur ka ambiente për intervistimin e fëmijëve ato nuk përdoren

- **Shembull:** Rekomandim për zbatimin efektiv të Marreveshjes së Bashkepunimit ndërmjet Policisë Shtetit dhe Urdhrit të Psikologut, për përditesimin e listës së psikologeve asistues për të miturit gjatë procesit të intervistimit nga OPGJ

**2.2 Kushtet në Komisariate:** Nga 44 inspektime (në ~90% të komisariateve) përsëriten dy shkelje thelbësore; a) nuk ka dhoma të ndara me vehte (mitur, burra, gra); b) Kushte jo dinjitoze të dhomave të shoqërimit në Komisarifat Kolonjë, Burrel, Kurbin, Bulqizë, Rrëshen, Librazhd, Devoll etj

**2.3 Reagimi institucional:** Policia pranoi 15 nga 18 rekomandime të Avokatit të Popullit, por monitorimi tregon se zbatimi i tyre në praktikë mbetet vetëm i pjesshëm.

# Konkluzione

- 1. Strukturat e Policisë së Shtetit duhet të në zbatim standardet e proporcionalitetit dhe nevojshmërisë;**  
Çdo ndërhyrje gjatë tubimeve duhet të jetë e justifikuar, minimale dhe në përputhje me standardet e Këshilli i Evropës dhe praktikën e Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
- 2. Trajnim i vazhdueshëm i efektivëve që marrin pjesë për garantimin e sigurisë publike;**  
Rritja e kapaciteteve mbi menaxhimin e turmave, de-eskalimin e situatave dhe respektimin e të drejtave themelore.
- 3. Qasje proaktive dhe lehtësuese ndaj tubimeve/ prezenca e autoambulancave;**  
Policia duhet të shohë rolin e saj si garantuese e ushtrimit të së drejtës për tubim, jo vetëm si organ kontrollues.
- 4. Transparencë dhe komunikim me organizatorët;**  
Vendosja e kanaleve të qarta komunikimi përpara dhe gjatë tubimeve për të shmangur tensionet dhe keqkuptimet.
- 5. Përdorimi i pajisjeve të identifikimit**  
Çdo efektiv duhet të jetë i identifikueshëm për të rritur llogaridhënien dhe besimin publik.
- 6. Dokumentim dhe raportim i plotë i ndërhyrjeve**  
Regjistrimi i veprimeve policore për të garantuar kontroll të mëvonshëm dhe transparencë.

# Çështja 2: Vonesat në Sistemin e Drejtësisë

## Gjetjet Paraprake: Aksesi dhe dështimi në fazën pasvendimore

1. **Sistemi punon nën kapacitet**, duke u kthyer në shkakun kryesor të zvarritjeve të proceseve gjyqësore. Backlogu i dosjeve për shqyrtim në total mbi 140 mijë çështje.
2. **Rritja e nevojës për ndihmë ligjore:** Për shkak të vonesave dhe vështirësive në akses, çështjet për ndihmë juridike dytësore u rritën nga 773 në 904 raste brenda vitit.
3. **Shkalla e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ**, në 10 vitet e fundit është vetëm 25%.
4. **Koha e pritjes për shqyrtimin e çështjeve deri në fazën e ekzekutimit të një vendimi**, qytetarët presin mesatarisht 7-8 vjet zbatimin e vendimeve të gjykatave kombëtare dhe 4 vjet e 3 muaj për të materializuar një vendim ndërkombëtar, duke e kthyer vonesën në një shkelje të re të të drejtave.

# 1. Problematika kryesore

## I) Për organin e prokurorisë: (83 ankesa/raste të trajtuara/ 62 raste në favor të ankuesve)

1. **Zvarritje të hetimeve penale**, për shkak të mungesës së ekspertizave, mosveprimeve hetimore dhe vonesave në letërporosi.
  - **Shembull:** Rekomandim për zvarritje të hetimeve për mbi 12 vite - mungesë informimi për familjarët dhe probleme në sigurimin e provave lidhur me procedimi penal nr. 1407/2012 (Korçë). **(pranuar/zbatuar)**
  - **Shembull:** Rekomandim mbi rasti i ekspertimit të ADN-së të viktimes, vonesa 5-vjeçare në hetim dhe 2 vite pa realizuar ekspertizën, për shkak të mungesës së alternativave efektive. **(pranuar/zbatuar)**
2. **Mungesë transparence dhe informimi** ndaj palëve (mosnjohim vendimesh, refuzim akses në dosje).
3. **Ndryshime të shpeshta të prokurorëve**, që dëmtojnë vijimësinë e hetimit.
4. **Mosrespektim i afateve procedurale** dhe probleme në ekzekutimin e vendimeve penale.
5. **Mosparaqitja e prokurorëve në seanca**, që sjell shtyrje të proceseve.
  - **Shembull:** Rekomandim mbi raste të mungesës së prokurorit në seanca, shtyrje për më shumë se 3 muaj, duke cenuar të drejtën e ankimit. **(pranuar/zbatuar)**
6. **Zbatim jo i njëtrajtshëm i ligjit për amnistinë**, për shkak të mungesës së koordinimit institucional.
7. **Rreziqe nga përdorimi i teknologjisë në hetim**, që mund të cenojnë privatësinë dhe të dhënat personale.

# Sistemi i Drejtësisë

**II) Për sistemin gjyqësor:** (143 ankesa/raste për proces të rregullt ligjor/ 82 raste në favor të ankuesve)

**2.1 Kapacitetet e sistemit:** Vetëm **272 gjyqtarë nga 408** (rreth 66% e organikës) / tregues i qartë i mbingarkesës strukturore

## 2.2 Problematikat:

a) **Zvarritje e proceseve gjyqësore**, veçanërisht në apel dhe në gjykatat e larta.

➤ **Shembull:** Rekomandim drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit: Çështje të pazgjidhura për 4–5 vite (pensione minatorësh dhe ushtarakësh).  
(2 pranuar/zbatuar)

b) **Vakanca të theksuara në sistem**, backlog i lartë dhe mbingarkesë e gjyqtarëve.

c) **Vonesa në arsyetimin dhe publikimin e vendimeve.**

➤ **Shembull:** Rekomandim lidhur me rastet e amnistisë ku një masë e konsiderueshme të dënuar nuk përfituan nga vonesa në arsyetimin e vendimeve, vonesa në ekzekutimin e vendimeve dhe mungesë koordinimi institucional. (pranuar/zbatuar)

d) **Vështirësi në sigurimin e përkthyesve dhe ekspertëve.**

➤ **Shembull:** Rekomandim rasti i mungesës së përkthyesit (shtetase rumune): 9 seanca të shtyra për mungesë përkthimi. (pranuar/proces zbatimi).

e) **Mungesë transparence në rendin e shqyrtimit të çështjeve** dhe perceptime për trajtim të pabarabartë.

f) **Probleme në njoftimin e palëve dhe aksesin në drejtësi**, sidomos pas hartës së re gjyqësore/Adresari i banesave .

g) **Dobësi infrastrukturore dhe mungesë teknologjie** në administrimin e çështjeve.

# Mos zbatimi i vendimeve të gjykatave përfshirë vendimet e GJEDNJ

## III) Në fazën pasvendimore:

- ▶ **Mosekzekutim ose vonesa në ekzekutimin e vendimeve**, përfshirë ato ndërkombëtare.
- ▶ Probleme në zbatimin e ligjit për amnistinë dhe në koordinimin mes institucioneve.
- ▶ Fakti që vetëm **25% e vendimeve janë ekzekutuar në 10 vitet e fundit** tregon një problem serioz në fazën pasvendimore:
- ▶ **Dobësi në mekanizmat shtetërorë të zbatimit**, përfshirë mungesën e koordinimit ndërinstytucional.
- ▶ **Mungesë vullneti apo prioriteti institucional**, për të zbatuar detyrimet ndërkombëtare.
- ▶ **Pasiguri juridike për qytetarët**, pasi fitimi i çështjes në nivel ndërkombëtar nuk garanton realizimin e së drejtës në praktikë.

Moszbatimi i vendimeve të kësaj gjykate minon **besueshmërinë e shtetit të së drejtës** dhe vendos në pikëpyetje efektivitetin e mekanizmave ndërkombëtarë të mbrojtjes së të drejtave.

# 3. Konkluzione

1. **E drejta për një proces të rregullt ligjor vijon të cenohet në mënyrë sistemike**, për shkak të faktorëve strukturorë dhe organizativë.
2. Problematikat janë **të përsëritura dhe jo sporadike**, duke reflektuar mangësi të thella në funksionimin e sistemit të drejtësisë.
3. **Mbingarkesa, vakancat dhe mungesa e koordinimit ndërinstytucional** janë shkaqet kryesore të vonesave dhe cenimeve të të drejtave.
4. Ndërhyrjet e Avokatit të Popullit kanë dhënë **rezultate konkrete në raste individuale**, por nuk mjaftojnë për të adresuar problemet strukturorë.
5. Kërkohet një **qasje e integruar reformuese**, që përfshin:
  - ❖ plotësimin e burimeve njerëzore;
  - ❖ përmirësimin e menaxhimit të çështjeve;
  - ❖ forcimin e transparencës dhe informimit;
  - ❖ garantimin e ekzekutimit efektiv të vendimeve;
6. Vetëm përmes këtyre masave mund të ngushtohet hendeku midis **garancive ligjore dhe realitetit praktik të drejtësisë** në Shqipëri.

# Çështja 3:

## Kushtet në Vendet e Privimit të Lirisë (Burgjet)

**Gjetjet Paraprake: Mbipopullimi dhe emergjenca shëndetësore:** (115 raste (ankesa/kërkesa dhe raste me iniciativë)

**1. Paraburgimi si normë:** 56.8% e personave në sistemin penitenciar (2,858 nga 5,029 persona) janë aty pa një vendim të formës së prerë (i.e. të padënuar), duke shkaktuar mbipopullim (psh. në Jordan Misja, Lezhë, Fier).

- ▶ Përqindja e lartë prej **56.8% e personave në sistemin penitenciar që ndodhen në paraburgim** (2,858 nga 5,029 persona) evidenton një devijim serioz nga parimi themelor i procesit penal, sipas të cilit **paraburgimi duhet të jetë masë e fundit dhe jo rregull i përgjithshëm**. Kjo situatë:
- ▶ Tregon përdorim të tepruar të masave shtrënguese, në kundërshtim me standardet e **proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë**.
- ▶ Cënon **parimin e prezumimit të pafajësisë**, pasi individët trajtohen në kushte izolimi përpara një vendimi përfundimtar gjyqësor.
- ▶ Kontribuon drejtpërdrejt në **mbipopullimin kronik të institucioneve penitenciare**, duke rënduar kushtet e jetesës dhe duke rritur tensionet mes të paraburgosurve dhe personelit.
- ▶ Në institucione si Jordan Misja, Lezhë dhe Fier, kjo përqindje e lartë materializohet në kushte konkrete mbipopullimi, ku kapacitetet tejkalohen dhe standardet minimale të trajtimit njerëzor vihen në rrezik.

## 2. Emergjenca Shëndetësore

### Trajtimi i të sëmurëve në burgje:

- ▶ Mungesa e një institucioni të posaçëm mjekësor për trajtimin e personave të privuar nga liria me probleme shëndetësore përbën një **dështim sistemik të shtetit** në përmbushjen e detyrimeve të tij:
- ▶ Personat me sëmundje kronike apo të rënda vazhdojnë të mbahen në **qeli të zakonshme burgu**, të papërshtatshme për trajtim mjekësor.
- ▶ Kjo situatë rrit rrezikun për **përkeqësim të gjendjes shëndetësore**, deri në pasoja të parikuperueshme.
- ▶ Mungesa e kujdesit adekuat bie ndesh me standardet e **Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 3)**, që ndalon trajtimin çnjerëzor dhe degradues.
- ▶ Gjithashtu, kjo situatë krijon një barrë shtesë për stafin penitenciar, i cili nuk është i trajnuar për të menaxhuar raste të natyrës mjekësore.

## 3. Kriza e personelit

Sistemi penitenciar përballet me një **mungesë strukturore dhe kronike të personelit mjekësor**, veçanërisht:

- ▶ Mjekë me kohë të plotë mungojnë në një numër të konsiderueshëm institucionesh.
- ▶ Psikiatrët janë pothuajse inekzistentë në shumicën e burgjeve, ndërkohë që numri i personave me probleme të shëndetit mendor është në rritje.

Kjo situatë:


- ▶ Kompromenton seriozisht **diagnostikimin dhe trajtimin në kohë** të të burgosurve.
- ▶ Rrit rrezikun e incidenteve, përfshirë **vetëdëmtimin dhe dhunën**.
- ▶ Evidenton mungesën e një politike të qëndrueshme për **integrimin e shërbimeve të shëndetit mendor** në sistemin penitenciar.

## 4. Infrastruktura në burgje

Infrastruktura në disa institucione përbën një tjetër problem madhor. Rekomandimet e Avokatit të Popullit për **mbylljen urgjente të disa godinave** (IEVP Burrel, Kosovë (Lushnjë), Kukës, 313 “Jordan Misja” (godina A) dhe Mine Peza) bazohen në:

- ▶ Amortizim të theksuar të ndërtesave, që nuk plotësojnë standardet minimale të sigurisë dhe higjienës.
- ▶ Kushte të papërshtatshme për jetesë, përfshirë lagështirë, mungesë ajrosjeje dhe hapësirë të pamjaftueshme.
- ▶ Rrezik real për **shëndetin dhe dinjitetin e personave të privuar nga liria**.
- ▶ Mosveprimi në këtë drejtim përbën jo vetëm neglizhencë administrative, por edhe shkelje të detyrimeve për garantimin e trajtimit dinjitoz.

# Monitorime në vendet e privimit të lirisë



# Konkluzione

## 1) Nevoje emergjente ulja e mbipopullimit ne burgje dhe përmirësimi i kushteve infrastrukturore:

- ❖ Përmirësimi të politikës penale (lehtësimi dhe jo ashpersimi të cilësimit të veprës penale)
- ❖ Përdorimi të masave alternative të masave të sigurisë
- ❖ Ulja e mbipopullimit rrit cilësinë e trajtimit të të burgosurve dhe përmirëson kushtet në burgje

## 2) Garantimi i **kujdesit shëndetësor cilësor** (fizik dhe mendor):

- ❖ Plotësimi i organikes me mjek të përgjithshëm dhe mjek specialist
- ❖ Ngritja e Institucionit të Vecantë Mjekësor për personat me masë mjekësore sipas parashikimeve ligjore;

## 3) Respektimi i **të drejtave themelore** sipas standardeve të Këshilli të Evropës:

- ❖ Përmirësimi i akteve të brendshme që lidhen me disa të drejta specifike si konfidencialiteti në trajtimin mjekësor të të burgosurve; takimet dhe komunikimet me median; përdorimin e pajisjeve kompjuterike etj.

## 4) Zgjerimi i programeve të **rehabilitimit dhe ri-integrimit social**:

- ❖ Shtimi i stafit psiko social
- ❖ Hartimi i programeve të detajuara individuale dhe në grup

## 5) **Trajnim dhe llogaridhënie** më e lartë e stafit penitenciar

## 6) Fuqizimi i monitorimit të brendshëm të sistemit penitenciar nëpërmjet mekanizmave të ankesave

# Çështja 4: Azili dhe Migracioni

**Gjetjet Paraprake: Boshllëqet në identifikim dhe qendrat e mbajtjes**

## **1. Fluksi i trajtuar:**

1.1 Të dhënat vjetore tregojnë se **778 migrantë janë evidentuar**, ndërkohë që janë monitoruar **537 intervista**, por vetëm **100 persona janë referuar zyrtarisht në sistemin e azilit**.

- **Shembull:** Rekomandim drejtuar Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, pasi nuk pranonte shoqërimin e një shtetasi të huaj, në kushtete e privimit të lirisë (i paraburgosur), në zyrën e Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, për të aplikuar për azil

Ky hendek i konsiderueshëm ndërmjet identifikimit dhe referimit:

1.2 Ngre shqetësime serioze mbi **efektivitetin e mekanizmave të filtrimit fillestar (pre-screening)**.

1.3 Sugjeron një nivel të lartë të **nën-identifikimit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare**.

1.4 Mund të çojë në situata të **refuzimit të heshtur (de facto)** të aksesit në azil, në kundërshtim me parimin e moskthimit (non-refoulement).

1.5 Në thelb, sistemi duket se nuk arrin të konvertojë në mënyrë proporcionale kontaktin fillestar me migrantët në procedura formale mbrojtjeje.

## 2. Mangësi në identifikim proaktiv

Evidentohet një dështim i vazhdueshëm për të zbatuar një qasje **proaktive dhe të ndjeshme ndaj vulnerabilitetit**, veçanërisht për:

- ▶ **Fëmijët e pashoqëruar**, të cilët kërkojnë trajtim të posaçëm dhe mbrojtje të menjëhershme.
- ▶ **Viktimat e trafikimit**, që shpesh nuk vetë-identifikohen dhe kanë nevojë për intervistim të specializuar.

Këto mangësi:

- ▶ Pëngojnë aktivizimin në kohë të **mekanizmave të mbrojtjes dhe referimit ndërinstytucional**.
- ▶ Rrisin rrezikun e **ekspozimit ndaj abuzimeve të mëtejshme**, përfshirë ri-trafikimin.
- ▶ Bien ndesh me standardet ndërkombëtare për trajtimin e grupeve vulnerabël, duke dëmtuar besueshmërinë e sistemit.
- ▶ Mungon një qasje e koordinuar mes strukturave të rendit, shërbimeve sociale dhe autoriteteve të azilit.

## 3. Boshllëqe procedurale

Proceset ekzistuese të “pre-screening” karakterizohen nga:

- ▶ **Mungesë standardizimi**, ku praktikat ndryshojnë nga një strukturë në tjetrën.
- ▶ Mungesë e **protokolleve të qarta dhe të detyrueshme** për intervistimin fillestar.
- ▶ **Përkthim i pamjaftueshëm dhe jo cilësor**, shpesh jo në kohë reale.

Këto problematika ndikojnë drejtpërdrejt në:

- ▶ Cilësinë dhe saktësinë e informacionit të mbledhur nga migrantët.
- ▶ Mundësinë për të identifikuar në mënyrë të drejtë nevojat për mbrojtje.
- ▶ Respektimin e të drejtës për një **proces të rregullt dhe të informuar**.
- ▶ Në mungesë të këtyre garancive, ekziston rreziku që vendimmarrja të bazohet në **të dhëna të paplota ose të pasakta**.

## 4. Kushtet në Qendra

Monitorimet në qendrat **Karreç, Babrru dhe Linzë** evidentojnë problematika të përsëritura në trajtimin e migrantëve:


- ▶ **Mungesë e mbështetjes psiko-sociale**, veçanërisht për individët që kanë përjetuar trauma.
- ▶ **Mungesë e mekanizmave efektivë të ankesave**, duke kufizuar mundësinë për të raportuar shkelje apo abuzime.
- ▶ Informim i kufizuar mbi të drejtat dhe procedurat, duke krijuar pasiguri dhe paqartësi.

Këto kushte:

- ▶ Cenojnë standardet e **trajtimit dinjitoz dhe human**.
- ▶ Rrisin nivelin e stresit dhe pasigurisë tek personat e mbajtur.
- ▶ Dobësojnë kontrollin institucional dhe llogaridhënien.
- ▶ Në mënyrë të përgjithshme, qendrat funksionojnë më shumë si struktura pritëse administrative sesa si ambiente që garantojnë mbrojtje dhe mirëqenie.

# Panorama e Flukseve Migratore

Viti 2025



# Konkluzione

1. **Identifikim dhe referim më efektiv** i azilkërkuesve dhe personave vulnerabël
2. **Akses i plotë në procedurat e azilit** (informim, përkthim, asistencë ligjore) sipas standardeve të UNHCR
3. **Përmirësim i kushteve të pritjes** dhe shërbimeve bazë
4. Mbrojtje e shtuar për **grupet vulnerabël** (fëmijë, gra, viktima trafikimi)
5. Kufizim i ndalimit, duke përdorur **alternativa ndaj ndalimit**
6. **Rritje e kapaciteteve institucionale** dhe bashkëpunimit me Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

# Pyetje për sallën: *Ftesë për të pranishmit për të dhënë kontributin e tyre:*

1. **Përputhshmëria:** A reflektojnë këto shifra dhe gjetje situatën reale që organizatat tuaja hasin në terren?
2. **Blind spots:** A ka dinamika apo raste specifike madhore në këto fusha që nuk janë kapur nga ky raport?
3. **Prioriteti i Avokimit:** Cila nga këto problematika duhet të jetë prioriteti i Avokatit të Popullit, për t'iu kërkuar llogari institucioneve dhe Kuvendit gjatë vitit 2026?

**FALEMINDERIT**



# **Të drejtat ekonomike, sociale dhe grupet vulnerabël**

**Seksioni i Përgjithshëm**

# Të drejtat ekonomike, sociale dhe grupet vulnerabël

## GJETJE TË PËRGJITHSHME:

- **Hendeku ndërmjet kuadrit ligjor dhe zbatimit efektiv të të drejtave mbetet problematika më e qëndrueshme strukturore.**

Në pothuajse të gjitha fushat, evidentohet se problemi nuk qëndron te mungesa e normave, por te zbatimi i pjesshëm, i vonuar ose joefektiv i tyre, për shkak të mungesës së transparencës, llogaridhënies, reagimit në kohë dhe kapaciteteve të mjaftueshme administrative. Kjo bën që garancitë formale të mos përkthehen gjithmonë në mbrojtje substanciale për qytetarin.

- **Pabarazitë në akses dhe mungesa e një qasjeje të koordinuar e të orientuar nga nevojat e grupeve vulnerabël përbëjnë problematikën e dytë madhore ndërsektoriale.**

Evidentohet se ushtrimi i të drejtave vijon të kushtëzohet nga vendbanimi, statusi social, gjendja ekonomike, përkatësia në grup vulnerabël dhe niveli i funksionimit të institucioneve vendore e qendrore, ndërsa bashkërendimi ndërinstitutional shpesh mbetet i fragmentuar ose i pamjaftueshëm. Si pasojë, mbrojtja e të drejtave realizohet në mënyrë të pabarabartë dhe jo njësoj efektive për të gjithë.

# Ndihma ekonomike

- U trajtuan **44 ankesa**, duke e bërë atë problematikën më të shpeshtë të kujdesit dhe përfshirjes sociale.
- **9 ankesa** lidhen me nevojën për shërbime sociale, cilësore dhe të barabarta
- U adresuan **6 rekomandime** institucioneve përgjegjëse në nivel qendror (2) dhe vendor (4).
- **Problematika kryesore** mbetet pamjaftueshmëria e mbështetjes ekonomike për garantimin e një jetese dinjitoze, me vështirësitë në aplikimet online, me mangësitë e sistemit të pikëzimit që nuk pasqyron gjithmonë realitetin socio-ekonomik të familjeve në varfëri të thellë, sidomos në zonat rurale.
  - ❖ **Shembull:** Rasti i Bashkisë Vorë, ku një familje në varfëri të thellë, me probleme serioze shëndetësore dhe të ardhura minimale, ishte përjashtuar nga skema për shkak të pikëzimit të pamjaftueshëm
- **Problematikat dytësore** lidhen me vonesa ose mospërfshirje në disa masa mbështetëse financiare të përfituesve që plotësojnë kriteret ligjore, kufizimet e masave të tjera mbështetëse financiare, të cilat janë vetëm për kategori të caktuara dhe nuk mbulojnë kostot bazë të jetesës, shëndetit dhe shërbimeve, si edhe me mungesën e një përcaktimi ligjor të minimumit jetik.
- **Minimumi jetik:** Mungesa në kuadrin normativ të një përcaktimi ligjor të minimumit jetik mbetet një mangësi që pengon vlerësimin real të varfërisë dhe përcaktimin e standardeve minimale të ndihmës ekonomike, pensioneve dhe përfitimeve, duke rrezikuar që qytetarët të mbeten nën nivelin minimal të jetesës.
- **KONKLUZION:** Monitorimi përgjatë vitit 2025 evidenton edhe kufijtë e ndërhyrjes korigjuese kur problematika ka karakter thellësisht strukturor. Edhe pse rastet individuale u zgjidhën pozitivisht, çështje si rishikimi i formulës së pikëzimit, forcimi i monitorimit në kohë reale dhe sidomos përcaktimi i minimumit jetik mbeten ende të hapura. Evidentohet se zbatimi i rekomandimeve ka qenë më i lehtë aty ku kërkohej korigjim procedural, ndërsa më i vështirë aty ku nevojitet reformim i politikës publike. Në këtë kuptim, monitorimi i vitit 2025 konfirmon se sfida kryesore nuk është vetëm zbatimi i rekomandimeve në raste konkrete, por kthimi i tyre në ndryshim sistematik të mënyrës se si konceptohet dhe administrohet ndihma ekonomike në Shqipëri.

## Strehimi social dhe kushtet e jetesës

- U trajtuan **26 ankesa** nga qytetarë dhe familje në situatë vulnerabël.
- U adresuan **5 rekomandime** institucioneve përgjegjëse në nivel vendor.
- **Problematika kryesore** mbetet mungesa e programeve efektive të strehimit social ose funksionimi i pamjaftueshëm i tyre në nivel vendor, duke lënë pa përgjigje të qëndrueshme nevojat për strehim të përshtatshëm..
- **Problematikat dytësore** lidhen me kapacitetet e kufizuara financiare dhe administrative të bashkive, me mungesën e reagimit të koordinuar në rastet emergjente të pastrehësisë dhe varfërisë ekstreme, si edhe me kushtet e jetesës nën standarde minimale në disa komunitete vulnerabël.
  - ❖ **Shembuj:** Rastet e trajtuara në Kukës, Himarë, Fier dhe në lagjen “Ish-Pjeshkore” në Berat tregojnë se cënimi i së drejtës për strehim të përshtatshëm shfaqet si në raste individuale emergjente, ashtu edhe në forma më të gjera komunitare me nevoja për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe infrastrukturës.

**Konkluzion:** Këto problematika tregojnë se e drejta për strehim vijon të çënohet jo vetëm nga mungesa e mbështetjes konkrete, por edhe nga boshllëqet në politikat vendore dhe në zbatimin e tyre. Rekomandimet kërkojnë jo vetëm zgjidhje për rastet konkrete, por edhe forcim të politikave vendore, zhvillim të programeve të qëndrueshme të strehimit social dhe forcim të kapaciteteve institucionale.

# Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

- ▶ U trajtuan 60 raste, 36 ankesa të paraqitura nga qytetarët dhe 24 raste me iniciativë.
- ▶ U adresuan 7 rekomandime institucioneve qendrore dhe vendore

## Problematikat kryesore

- ▶ **Përshtatshmëria ndërtimore për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim në Qendrat e Votimit, në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2025:** Monitorimet treguan se aksesueshmëria në institucione dhe në qendrat e votimit mbetet e pamjaftueshme, si për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje, ashtu edhe për personat me aftësi të kufizuara në shikim.
  - ❖ **Shembull:** Në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2025, Avokati i Popullit iu drejtua 61 bashkive me rekomandime për krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, të cilat u pranuan, por u zbatuan vetëm pjesërisht.
- ▶ **Aksesueshmëria në infrastrukturë dhe shërbime publike:** Është evidentuar mungesë sinjalistike, parkimesh të dedikuara dhe standardesh aksesueshmërie në shërbimet postare e bankare, çka tregon hendek mes angazhimeve institucionale dhe zbatimit praktik.
  - ❖ **Shembuj:** Për mungesën e aksesit në Zyrën Postare Dobraç, u rekomanduan masa për përshtatshmërinë ndërtimore të zyrave postare, duke sjellë vendosjen e rampës dhe angazhime për përmirësim më të gjerë të aksesueshmërisë.
  - ❖ Për mungesën e përshtatshmërisë së infrastrukturës rrugore dhe parkimeve të dedikuara, iu rekomandua Bashkive Laç dhe Gjirokastër miratimi i planeve konkrete të masave, ndërsa vetëm Bashkia Gjirokastër raportoi zbatim praktik.
- ▶ **Përfitimet sociale dhe mekanizmat e vlerësimit:** Është evidentuar moszbatim i akteve nënligjore për kompensimin e paketës higjieno-sanitare, si dhe problematika në përcaktimin e nivelit të aftësisë së kufizuar pas zbatimit të skemës së re të vlerësimit.
  - ❖ **Shembull:** Për përfitimin e paketës higjieno-sanitare, Avokati i Popullit iu drejtua MSHMS me rekomandim për zbatimin e plotë të legjislacionit, ndërsa ministria referoi masa të parashikuara në projektbuxhetin afatmesëm 2026–2028.

# Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

- ▶ **Mbështetja për jetesë të pavarur:** Nuk subvencionohen mjetet ndihmëse për personat me Statusin e të Verbërit dhe nuk njihet vjetërsia në punë e ndihmësve personalë për efekt pensioni, përveç rasteve të përfituesve me statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.
  - ❖ **Shembull:** Për mosnjohjen e vjetërsisë në punë të ndihmësve personalë, MSHMS konfirmoi se kjo çështje mbetet në fokus të përmirësimit të politikave dhe legjislacionit në fushën e mirëqenie sociale.
- ▶ **Konkluzione:** gjatë vitit 2025, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara vijuan të përballen me mangësi strukturore në zbatim, pavarësisht disa përmirësimeve konkrete në raste individuale dhe në rritjen e vëmendjes institucionale. Problematikat më të theksuara mbetën aksesueshmëria, funksionimi i mekanizmave të vlerësimit, mbështetja me mjete ndihmëse dhe mungesa e zgjidhjeve të plota për garantimin real të barazisë në shërbime. Në thelb, sfida kryesore mbetet zbatimi efektiv i politikave dhe sigurimi i burimeve të nevojshme për një mbrojtje reale dhe të qëndrueshme të kësaj kategorie.

# E drejta për sigurime shoqërore

- **U trajtuan 67 raste**, ankesa të paraqitura nga qytetarët dhe raste me iniciativë.
- **U adresua 1 rekomandim** institucioneve qendrore dhe vendore

## Problematikat kryesore

- **Cënimi i parimit të ligjshmërisë në llogaritjen e përfitimeve:** Është konstatuar pasaktësi në përlllogaritjen e masës fillestare të pensioneve të pleqërisë, shpesh e shoqëruar me mosnjohjen e periudhave të vjetërsisë në punë, pavarësisht dokumentacionit provues të paraqitur nga qytetarët. Është konstatuar gjithashtu nivel i ulët përfitimi në raport me periudhën e sigurimit dhe pritshmëritë ligjore të përfituesve.
  - ❖ **Shembull:** Disa ankesa u zgjidhën pozitivisht, pas ndërhyrjeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore,, duke sjellë rishikimin e llogaritjes së pensionit, ndryshimin e masës së përfitimit dhe njohjen e shtesave kreditore
- **Vonesa procedurale dhe heshtja administrative:** Një problematikë e mprehtë mbetet mungesa e përgjigjeve brenda afateve ligjore ndaj kërkesave për rishqyrtim të masës së pensionit ose për përfitim të pensionit të posaçëm shtetëror. Kjo heshtje jo vetëm që cenon të drejtën për informim, por pengon qytetarin në ndjekjen e mjeteve të tjera të ankimit.
  - ❖ **Shembull:** Avokati i Popullit ka kërkuar zyrtarisht nga Komisioni i Dhënies së Pensioneve të Veçanta pranë Këshillit të Ministrave trajtimin e kërkesave të prapambetura dhe kthimin e një përgjigjeje të rregullt, për të shmangur pasigurinë juridike të qytetarëve.
  - ❖ Në rastet më komplekse që kërkonin rrugë gjyqësore, Avokati i Popullit ka orientuar qytetarët drejt strukturave të ndihmës juridike falas, për të garantuar që mungesa e një zgjidhjeje administrative të mos pengojë aksesin në drejtësi.

# E drejta për sigurime shoqërore

- **Mungesa e transparencës administrative:** Janë evidentuar raste të refuzimit të pajustificuar për të vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë të dosjes së pensionit, duke i lënë përfituesit në pamundësi për të verifikuar korrektësinë e veprimeve të administratës publike.
  - ❖ **Shembull:** Qytetarët janë udhëzuar mbi procedurat e ankimit në Komisionet Rajonale dhe Qendrore të Apelit, me synim forcimin e kontrollit administrativ dhe garantimin e një procesi më të qartë e të verifikueshëm për shqyrtimin e kërkesave të tyre
- **Moslidhje, mospërfitimi dhe ndërprerja e pajustificuar e përfitimeve:** Janë konstatuar raste të moslidhjes së pensionit të pleqërisë pavarësisht plotësimin të kushteve ligjore, dhe të ndërprerjes apo mospërfitimit të pensionit suplementar pa një njoftim paraprak dhe pa një vendimarrje të arsyetuar administrative.
- **Konkluzione:** sfidë mbetet ndjekja dhe monitorimi i çështjeve me karakter strukturor dhe buxhetor, si reformimi i skemës së pensioneve dhe trajtimi i pensioneve të posaçme shtetërore, veçanërisht në kushtet kur kuadri aktual kufizon numrin e tyre në jo më shumë se 15 në vit. Pavarësisht ekzistencës së një kuadri ligjor të përcaktuar, praktika administrative vijon të shfaqë mangësi në transparencë, saktësinë e llogaritjes dhe reagimin në kohë të institucioneve, duke cenuar ushtrimin efektiv të të drejtës për sigurime shoqërore dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë ekonomike dhe dinjitetin e pensionistëve e përfituesve të tjerë, sidomos në kushtet e rritjes së kostos së jetesës

# E drejta për kujdes shëndetësor

- ▶ U trajtuan **41 ankesa dhe raste me iniciativë** në lidhje me Kujdesin Shëndetësor.
- ▶ U adresuan **5 rekomandime** institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

## Problematikat kryesore

- ▶ **Cilësia dhe standardi i kujdesit shëndetësor:** Në disa raste është evidentuar trajtim jo plotësisht në përputhje me standardet mjekësore, çka lidhet me mungesën e protokolleve të unifikuara dhe zbatimin jo të qëndrueshëm të praktikave profesionale. Gjithashtu, burokracia dhe radhët e gjata në institucionet shëndetësore ndikojnë negativisht në aksesin real të qytetarëve në shërbim.
- ▶ **Furnizimi me barna dhe pajisje mjekësore:** Mungesa e barnave, veçanërisht për patologji të rënda, si dhe aksesin i kufizuar në pajisje diagnostike të avancuara, përbëjnë pengesa të rëndësishme në realizimin efektiv të së drejtës për shëndet. Po ashtu, mos përfshirja e disa barnave në listën e rimbursimit ndikon drejtpërdrejt në barrën financiare të pacientëve.
  - ❖ **Shembuj:** Sëmundjet e rralla shpesh injorohen. Institucioni kërkoi nëpërmjet Rekomandimit drejtuar MSHMS, përfshirjen e mjekimit për 19 pacientë me sëmundjen e “Ataksisë e Friedreich” në listën e barnave të rimbursueshme.
  - ❖ Pacientët me kancer gjiri adresuan problematikat e Spitalit onkologjik në QSUT: U rekomandua MSHMS përmirësimi i trajtimit dhe mbështetjes për këtë kategori pacientësh
- ▶ **Pabarazitë territoriale në ofrimin e shërbimeve:** Qendrat shëndetësore në zonat rurale dhe të largëta shpesh nuk ofrojnë gamën e plotë të shërbimeve për shkak të mungesës së personelit, shpërndarjes së pabarabartë të burimeve njerëzore dhe mungesës së investimeve infrastrukturore. Kjo krijon një hendek të dukshëm midis standardeve ligjore dhe mundësisë reale për të marrë shërbim cilësor.
  - ❖ **Shembull:** Shtetasit e Kosovës dhe dializa: U rekomandua trajtim i barabartë në aksesin ndaj shërbimit të dializës për shtetasit kosovar kur janë në Shqipëri.

# E drejta për kujdes shëndetësor

- ▶ **Mungesat infrastrukturore dhe organizative:** Në disa institucione shëndetësore janë konstatuar probleme serioze në infrastrukturë, pajisje dhe organizim, të cilat ndikojnë në cilësinë dhe vijueshmërinë e shërbimeve. Këto mangësi kërkojnë ndërhyrje të thelluara dhe investime të qëndrueshme.
  - ❖ **Shembull:** Inspektimet e kryera në Spitali “Shefqet Ndroqi”, Tiranë dhe Spitalin Rajonal Kukës adresuan me Rekomandim ndërhyrje dhe investime për përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve spitalore. Rekomandimet u pranuan nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, një pjesë janë pranuar dhe implementuar ndërsa pjesa tjetër është shtyrë në kohë dhe varet nga buxheti.
  - ❖ Qendra Socio-Shëndetësore Selitë: U rekomandua spostimi i menjëhershëm i kontenierëve të mbetjeve dhe evidentimi i rasteve të ngjashme për të garantuar kushte të sigurt higjiëno-sanitare.
- ▶ **Akresi i kufizuar për grupet vulnerabël:** Pacientët me sëmundje të rënda apo të rralla përballen me vështirësi të shtuara në sigurimin e trajtimit të nevojshëm, për shkak të kostove të larta, mungesës së barnave të rimbursueshme dhe kapaciteteve të kufizuara të sistemit.
- ▶ **Konkluzione:** Monitorimi gjatë vitit 2025 tregon se realizimi i së drejtës për kujdes shëndetësor mbetet i pabarabartë dhe jo plotësisht efektiv. Ndërsa ndërhyrjet administrative dhe masat lokale kanë sjellë përmirësime në raste konkrete, problematikat që kërkojnë reforma strukturore, investime financiare dhe riorganizim të sistemit vazhdojnë të mbeten sfiduese. Kjo situatë dëshmon se sfida kryesore nuk qëndron vetëm në ekzistencën e një kuadri të konsoliduar ligjor, por në aftësinë e institucioneve për ta përkthyer atë në shërbime reale, cilësore dhe të barabarta për të gjithë qytetarët. Për këtë arsye, kërkohet një qasje më e qëndrueshme, e integruar dhe e orientuar drejt rezultateve konkrete, në mënyrë që e drejta për kujdes shëndetësor të mos mbetet një garanci formale, por të materializohet në praktikë.

# E drejta për arsim

- U trajtuan **80 ankesa** për të drejtën për arsim për fëmijë (disa ardhur nga vetë fëmijët) dhe **56 ankesa** nga student për arsimin e lartë.
- U adresuan **5 rekomandime** institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

## Problematikat kryesore

- **Cilësia e mësimdhënies dhe qëndrueshmëria e saj:** Janë evidentuar problematika që lidhen me nivelin dhe qëndrueshmërinë e cilësisë në mësimdhënie, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në formimin akademik dhe profesional të studentëve.
- **Pabarazitë në akses:** Pabarazitë rajonale dhe sociale vijojnë të ndikojnë në mundësitë reale për ndjekjen e arsimit, duke krijuar diferenca në përfitimin e tij ndërmjet kategorive të ndryshme të popullsisë.
- **Financimi i pamjaftueshëm i sistemit arsimor:** Mungesa e financimit të mjaftueshëm reflektohet në infrastrukturë të pamjaftueshme, mbështetje të kufizuar për kërkimin shkencor dhe kushte jo të favorshme për personelin akademik dhe mësuesor.
- **Mospërputhja me tregun e punës:** Programet studimore në disa raste nuk janë të përshtatura me kërkesat e tregut të punës, duke krijuar vështirësi në integrimin profesional të të diplomuarve.
  - ❖ **Shembull:** Të diplomuarit në “Shkenca të Rehabilitimit”, Univ.Sporteve prej vitesh endeshin pa zgjidhje: U rekomandua MA-së njohja e profesionit “Rehabilitues” si profesion i rregulluar dhe ndërmarrja e nismave ligjore përkatëse.

# E drejta për arsim

- **Digjitalizimi dhe inovacioni i kufizuar:** Niveli i digjitalizimit dhe përdorimit të teknologjisë në sistemin arsimor mbetet ende i kufizuar, duke ndikuar në cilësinë dhe efektivitetin e procesit mësimor, si dhe njohjen e studimeve online.
  - ❖ **Shembull:** Njohja e diplomës online nga student jashtë vendit, nga MA dhe QSHA: U rekomandua ndryshimi i aktit nënligjor për të lejuar njohjen e diplomave të përfituara online sipas dokumentacionit zyrtar.
- **Dobësi në autonominë akademike:** Janë konstatuar kufizime në ushtrimin efektiv të autonomisë institucionale, sidomos në proceset vendimmarrëse që lidhen me kurrikulat dhe organizimin akademik.
- **Vështirësi socio-ekonomike për studentët:** Rritja e kostos së jetesës, tarifat e studimit, vështirësitë në përfitimin e bursave dhe vonesat në njohjen e diplomave të huaja përbëjnë pengesa konkrete në aksesin dhe vijueshmërinë e arsimit.
  - ❖ **Shembull:** Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër: U rekomandua interpretimi korrekt i legjislacionit dhe zbatimi i uljes 50% të tarifës për studentët Master me prind me aftësi të kufizuara, si dhe informimi për të drejtën e ankimit.
- **Motivimi i pamjaftueshëm i personelit arsimor:** Mbështetja financiare për mësuesit dhe pedagogët mbetet e pamjaftueshme për të garantuar motivim të qëndrueshëm dhe zhvillim profesional cilësor.
  - ❖ **Shembull:** Mësuesja me aftësi të kufizuara A.B largohet nga puna në Fier: U rekomandua rikthimi i saj në punë pranë vendbanimit dhe marrja e masave disiplinore ndaj përgjegjësve.
- **Konkluzione:** Monitorimi gjatë vitit 2025 evidenton se realizimi i së drejtës për arsim mbetet i ndikuar nga faktorë strukturorë që lidhen me financimin, aksesin, cilësinë dhe funksionalitetin e sistemit arsimor. Ndërsa në disa raste ndërhyrjet institucionale kanë mundur zgjidhje konkrete, problematikat që kërkojnë reforma më të thelluara dhe politika afatgjata vijojnë të mbeten sfiduese. Rrjedhimisht sfida kryesore nuk qëndron vetëm në garantimin formal të së drejtës për arsim, por në përkthimin e saj në mundësi reale, të barabarta dhe cilësore për të gjithë qytetarët. Për këtë arsye, kërkohet një qasje e integruar dhe e qëndrueshme, e orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, forcimit të autonomisë akademike, rritjes së mbështetjes financiare dhe përshtatjes së sistemit arsimor me nevojat e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik.

# E drejta për Mjedis të Shëndetshëm

- U trajtuan **54 ankesa dhe raste me iniciativë** në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
- U adresuan **11 rekomandime** institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

## Problematikat Kryesore

- **Mbetjet urbane, inerte dhe të rrezikshme:** depozitimi i pakontrolluar, djegia e mbetjeve dhe mungesa e planifikimit vendor vijojnë të jenë problematika të theksuara, ndërsa kontrollet administrative mbeten të pamjaftueshme.
  - ❖ **Shëmbull:** Situata në lumin Kir, Shkodër, dëshmon se ndërhyrjet e herëpashershme për pastrimin e mbetjeve janë të pamjaftueshme në mungesë të një qasjeje të integruar dhe të qëndrueshme. Janë ndërmarrë masa pastrimi të pjesshme, por mungon qasja e integruar dhe parandaluese.
- **Ndotja akustike:** mungesa e matjeve objektive, reagimi i vonuar institucional dhe moszbatimi i standardeve teknike ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës.
  - ❖ **Shëmbull:** Në Kukës, matjet evidentojnë tejkalim të niveleve kufi të zhurmës, pa masa administrative të plota.
- **Ndotja në Liqenin e Komanit:** ndërhyrjet mbeten të pjesshme për shkak të mungesës së mjeteve, fondeve dhe koordinimit ndërinstytucional.
  - ❖ **Shëmbull:** Liqeni i Komanit ilustron natyrën ndërterritoriale të problematikës dhe vështirësitë në menaxhimin efektiv të saj.

# E drejta për Mjedis të Shëndetshëm

- ▶ **Ndotja e ajrit nga veprimtari pa leje mjedisore:** vijon të krijojë shqetësime konkrete për komunitetin përmes tymrave, erërave, zhurmave dhe emetimeve të tjera.
  - ❖ **Shembull:** Në Balëz, Elbasan, një qendër trajtimi kimikatesh funksionon pa leje mjedisore dhe pa Vlerësim të Ndikimit në Mjedis, në afërsi të një shkolle.
- ▶ **Ujërat e ndotura dhe kanalizimet:** mungesa e investimeve të koordinuara dhe zgjidhjet e përkohshme vijnë të mos përmbushin standardet mjedisore.
  - ❖ **Shembull:** Në Plepa–Shkëmbi i Kavajës, një kanal për ujërat e shiut funksionon në praktikë si pjesë e rrjetit të kanalizimeve.

## Konkluzione:

- ▶ Në plan analitik, monitorimi i vitit 2025 konfirmon se vështirësia kryesore në këtë fushë nuk qëndron vetëm te konstatimi i ndotjes ose te identifikimi i problematikës, por te aftësia e institucioneve për të kaluar nga reagimi episodik në ndërhyrje të qëndrueshme, të matshme dhe afatgjata.
- ▶ Kapacitetet e pamjaftueshme për monitorim dhe inspektim, shoqëruar me një koordinim të dobët ndërinstytucional, mbeten pengesa kryesore për një trajtim efektiv. Reagimi i pamjaftueshëm institucional ka dëshmuar mungesë të angazhimit të duhur për trajtimin efektiv dhe në kohë të problematikave mjedisore.

# Të drejtat e grave, Barazia Gjinore

- **U trajtuan 14 ankesa** dhe raste me iniciativë me problematika që vinin si pasojë e dhunës në familje:
- **U inspektuan 4 qendra/strehëza** për viktimat e dhunës në familje.
- **U adresuan 9 rekomandime** institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

## Problematikat kryesore

- **Klima polarizuese dhe diskursi publik përjashtues:** Gjatë vitit 2025 u evidentua një rritje e narrativave stigmatizuese, gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit, veçanërisht ndaj organizatave të shoqërisë civile, aktivistëve/aktivisteve dhe grave në jetën publike.
- **Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna digjitale:** U konstatuan forma të përhapura të dhunës, përfshirë kërcënimet, bullizimin dhe fushatat denigruese online ndaj grave dhe vajzave, veçanërisht ndaj figurave publike dhe kandidateve në zgjedhje.
- **Pabarazitë në ushtrimin e të drejtave politike:** Gratë kandidate dhe përfaqësuese politike u përballën me stereotipe gjinore, trajtim të pabarabartë dhe sulme seksiste, duke kufizuar përfaqësimin e tyre real dhe të barabartë.
- **Funksionim i pabarabartë i mekanizmave të koordinuar të referimit:** Megjithëse Mekanizmat e Koordinuar të Referimit janë ngritur në të gjitha bashkitë, efektiviteti dhe kapacitetet e tyre mbeten të ndryshme, me boshllëqe në identifikimin, trajtimin dhe monitorimin e rasteve.
- **Mungesë e aksesit dhe informacionit për gratë:** Shumë gra hasin vështirësi në raportimin e dhunës dhe ndjekjen e procedurave ligjore për shkak të mungesës së informacionit, barrierave ekonomike dhe vështirësive që lidhen me reformën në drejtësi.
- **Infrastrukturë e pamjaftueshme sidomos për gratë nga grupet me përkatësi të shumfishtë dhe jo e standardizuar e shërbimeve të strehimit emergjent dhe afatgjatë:** Pavarësisht ekzistencës së strehëzave dhe shërbimeve emergjente, mbeten sfida në cilësinë, shpërndarjen territoriale dhe kapacitetet për rastet me risk të lartë.

# Të drejtat e grave, Barazia Gjinore

- ▶ **Në kuadër të Observatorit për Femicidet u evidentuan, mangësi në parandalimin dhe adresimin e femicidit:**
- ▶ U zgjerua fusha e analizës duke përfshirë dhe vepra penale që lidhen me format ekstreme të dhunës ndaj grave dhe vajzave. U përgatit Raporti me të dhënat për vitin 2024, i cili analizoi 18 raste konkretisht: 5 vrasje nga të cilat 3 femicide; 6 tentativa vrasjeje; 3 plagosje të rënda me dashje; 4 raste shkaktimi vetëvrasjeje.

## Disa nga gjetjet e raportit:

- ▶ 56% e rasteve me banim në zona rurale;
- ▶ **72% e rasteve** – viktimat kishin histori të mëparshme dhune;
- ▶ 5 viktima kishin kërkuar ndihmë më parë nga policia;
- ▶ Asnjë rast nuk ishte e pajisur me UPMM/UMM/UM në momentin e ngjarjes;
- ▶ Viktimat ishin nëna të **33 fëmijëve**;
- ▶ **Konkluzione:** Monitorimi gjatë vitit 2025 evidenton se, pavarësisht përparimeve të rëndësishme në planin normativ dhe institucional, sfidat kryesore mbeten në zbatimin efektiv të kuadrit ligjor dhe në adresimin e pabarazive strukturore. Ndërsa ndërhyrjet administrative dhe rastet individuale të trajtuara nga AP kanë gjetur shpesh zgjidhje në mbi 80% të rasteve, problematika që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, funksionimi i mekanizmave të koordinuar të referimit në nivel vendor, aksesit në shërbime dhe përfshirja reale e grave në jetën publike kërkojnë qasje më të thelluar dhe ndërhyrje sistematike nga institucionet përgjegjëse.
- ▶ Në këtë kuptim, sfida nuk qëndron vetëm në forcimin e garancive ligjore nëpërmjet miratimit të një kuadri ligjor në përputhje me angazhimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, por në sigurimin e një zbatimi të qëndrueshëm dhe të barabartë të tyre, në mënyrë që barazia gjinore të mos mbetet një standard formal, por të përkthehet në realitet konkret për gratë dhe vajzat në Shqipëri.

# Të drejtat e personave LGBTIQ

- U trajtua çështja e ngritur nga një grup organizatash të shoqërisë civile lidhur me propozimin për ndryshim të Ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, "Për gjendjen civile", i ndryshuar, përmes të cilit synohej të përfshihej në ligj koncepti i "gjinisë biologjiksht të pandryshuar". Argumentet për mosmbështetjen e kësaj nisme iu përcollën organizatave kërkuese.

## Problematikat kryesore

- **Hendek në kuadrin ligjor dhe zbatimit të të drejtave në praktikë:** Megjithëse ekzistojnë garanci ligjore kundër diskriminimit, gëzimi efektiv i të drejtave nga komuniteti LGBTIQ+ mbetet i kufizuar. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit mbetet i dobët, ndërhyrjet ligjore të parashikuara në këtë plan për njohjen e partneriteteve civile dhe identitetit gjinor nuk kanë avancuar, ndërsa raportimi periodik institucional mbi zbatimin e planit nga MSHMS ende nuk është bërë.
- **Rritje e gjuhës së urrejtjes dhe presionit publik,** që çon në krijimin e një klime frenuese për ushtrimin e lirive themelore: Gjatë vitit 2025 u evidentua intensifikim i gjuhës së urrejtjes, kërcënimeve dhe formave të tjera të presionit verbal, veçanërisht në rrjetet sociale dhe në debatet publike. Këto ishin të lidhura me debatin publik për Ligjin e Barazisë Gjinore, drejtuar ndaj aktivistëve të shoqërisë civile që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e komunitetit LGBTIQ dhe grave.
- **Diskriminim në fusha kyçe të jetës:** Referuar takimeve, tryezave, vëzhgimeve dhe raporteve të organizatave, personat LGBTIQ+ vijojnë të përballen me diskriminim në punësim, arsim, shërbime shëndetësore dhe strehim, duke kufizuar përfshirjen e tyre të plotë në shoqëri.
- **Vulnerabilitet i shtuar i personave transgjinorë:** Mungesa e procedurave për njohjen ligjore të identitetit gjinor, vonesat në miratimin e protokolleve shëndetësore dhe stigmatizimi shoqëror krijojnë barriera të shumëfishta për këtë kategori.
- **Nënraportim i dhunës dhe diskriminimit:** Incidentet e dhunës dhe ngacmimit mbeten shpesh të padeklaruara për shkak të frikës nga stigmatizimi, ekspozimi dhe mungesa e besimit të institucionet.
- **Kapacitete të pamjaftueshme institucionale:** Nevojitet forcim i rolit të organeve ligjzbatuese në trajtimin e rasteve të diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes, si dhe përmirësim i mbledhjes së të dhënave.
- **KONKLuzion:** Progresi i arritur gjatë vitit 2025 mbetet kryesisht në planin normativ, ndërkohë që mbrojtja efektive e të drejtave të komunitetit LGBTQ+ vijon të përballlet me pengesa serioze në praktikë. Për të reduktuar këtë hendek, kërkohet një angazhim më i qëndrueshëm ndërinstytucional, fuqizim i mekanizmave të reagimit ndaj diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes, mbledhja sistematike e të dhënave, si dhe zhvillim i politikave publike të matshme që garantojnë barazi reale, jo vetëm formale.

# Të drejtat e pakicave kombëtare

- U trajtuan **27 ankesa dhe raste me iniciativë** që lidhen me të drejtat e pakicave kombëtare,
- Janë adresuar **8 rekomandime** në institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor .
- **Problematikat Kryesore**
- **Kushtet e jetesës, strehimi dhe infrastruktura bazë:** komunitetet rome dhe egjiptiane vijojnë të përballen me mungesë të ujit, energjisë, kanalizimeve dhe me kushte të rënda sanitare.
  - ❖ **Shembull:** Në zonën “Tepe”, në Shkodër, janë evidentuar kushte të papërshtatshme jetese për komunitetin rom të zhvendosur.
- **Regjistrimi civil dhe vendbanimi faktik:** mungesa e regjistrimit civil dhe e përditësimit të vendbanimit krijon pengesa serioze në aksesin në të drejta dhe shërbime publike.
  - ❖ **Shembull:** Janë evidentuar raste të pamundësisë për njohjen e atësisë, pagesën e lejes së lindjes dhe përfitimin e ndihmës për shpenzimet e varrimit.
- **Arsimi në gjuhën amtare dhe ruajtja e identitetit gjuhësor:** garantimi i së drejtës për arsimim në gjuhën amtare dhe promovimi i gjuhës rome mbeten të pamjaftueshme.
  - ❖ **Shembull:** Në zonën Mbrostar, është kërkuar marrja e masave për përmbushjen e së drejtës për arsimim në gjuhën amtare të pakicës rome.
- **Përfshirja sociale dhe barazia efektive:** komunitetet rome dhe egjiptiane vijojnë të përballen me diskriminim strukturor, kushte jetese nën standarde dhe pengesa në aksesin në shërbime.
  - ❖ **Shembull:** Në Baltëz, Fier, problematikat infrastrukturore që prekin rreth 350 familje të komunitetit rom tregojnë mungesën e ndërhyrjeve të qëndrueshme.
- **Transparenca administrative dhe pjesëmarrja efektive:** procedurat që lidhen me përfaqësimin dhe mbështetjen e organizatave të pakicave kërkojnë më shumë transparencë dhe mekanizma efektivë ankimi.
  - ❖ **Shembull:** Janë rekomanduar masa për përmirësimin e procedurave administrative pranë Bashkisë Tiranë dhe Komitetit për Pakicat Kombëtare.
- **Konkluzione:** Progresi në mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare mbetet i pjesshëm, pasi rekomandimet që kërkojnë ndërhyrje strukturale dhe koordinim ndërinstitutional hasin vonesa në zbatim. Problematikat e konstatuara dëshmojnë nevojën për një qasje më të koordinuar, më proaktive dhe të qëndrueshme nga institucionet publike, me qëllim garantimin e barazisë efektive dhe mbrojtjes reale të të drejtave të pakicave kombëtare